POP 5
Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 FOTO/ Rita Ora tërheq vëmendjen në Javën e Modës në Paris, shfaqet me një fustan të tejdukshëm
2 Atentati me 2 viktima në Rinas, policia shqetësohet nga personi për ta marrë në pyetje
3 'Shqipëria Bihet' protestë para Kryeministrisë, penalizoje me policinë për çedrat, Lapaj: Do vendosim qindra, s'na intimidojnë dot (VIDEO)
4 Krystari i Dumës në Maskë 'maskton' Politikë me një meme për Dielliin
5 AF Elbasani mposht Vllaznimi dhe kryeson Superligën, shënt në tribuna e dhoratë e zhvesh(ja) Humbet Flamurtari, Moniaro kritika të fjetë

Kronikë

Plagosje me armë zjarri në Berat, 37-vjeçari përfundon tek Trauma në gjendje të rëndë! Konflikti nisi për parakalimin e automjeteve (EMRI)

Sherri ka nisur për një parakalim mjetesh dhe i plagosuri ka dalë nga makina për tu sqaruar me shoferin, kur është qëlluar prej tij me plumb në bark. I plagosuri Fabjel Toska (Xhindi),37-vjeç,është transportuar drejt Spitalit të Traumës, në gjendje të rëndë.

Redaksia
7 Dhjetor, 08:45 | **Përditësimi: 7 Dhjetor, 17:13**

Share

Një plagosje me armë zjarri është regjistruar në Berat teksa 37-vjeçari Fabiel Toska Xhindi, është paraqitur në spital për të marrë ndihmë mjekësore pasi ishte i plagosur me armë zjarri në vendin e quajtur "Dogana".

Fillimisht kanë qenë të paqarta rrethanat e ngjarjes por, pasi grupi hetimor ka punuar intensivisht në këqyrjen e kamerave të sigurisë të marra nga bizneset dhe banesat rreth zonës, është zbuluar edhe dinamika e ngjarjes. Mësohet se i plagosuri, Fabiel Toska (Xhindi),ka qenë duke udhëtuar me një mjet tip Seat, me një shokun e tij në aksin nacional Kombinat-Dimal. Nga pamjet filmike, duket edhe një mjet tjetër, fuoristradë me ngjyrë të zezë dhe të dyja mjetet parakalohen disa herë me njëra-tjetrën.

Pas kësaj, i plagosuri del nga mjeti dhe shkon me vrap tek makina tjetër, nga ana e shoferit (për tu sqaruar me të se përse po e ndiqte nga prapa dhe po e parakalonte) por sapo shoferi hap xhamin e qëllon me një plumb në bark. Nga mjeti tip Seat duket se del edhe shoku i të plagosurit por sapo e sheh që Fabielin e qëllojnë me armë dhe bie në tokë, ai ikën më vrap dhe njofton policinë.

LEXO EDHE:
Ervin Ceca betohet si kryebashkiak i Beratit: Nëpërmjet bashkëpunimit, do të arrijmë rezultate! Ministri Demo: Do të ruajë vlerat e qytetit

Burimet policore konfirmojnë se i plagosuri dhe shoku me të cilin ishte në makinë nuk kanë pasur njohje të mëparshme me personat e tjerë, thënë kjo edhe në deklaratat që kanë dhënë të dy gjatë pyetjes nga inspektorët e krimeve në DVP Berat. Pas plagosjes, Fabiel Toska (Xhindi), 37-vjeç, banues në lagjen "Çlirim" në Berat, është transportuar me ambulancë drejt Spitalit Rajonal Berat, ku pasi ka marrë mjekimin e nevojshëm, është transportuar drejt Spitalit të Traumës në gjendje të rëndë.

Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë, është duke vijuar intensivisht hetimet për zbardhjen e rrethanave dhe sigurimin e provave me qëllim dokumentimin e plotë ligjor të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

> *"Berat/Informacion paraprak*
>
> *Rreth orës 00:55, është dërguar në spital për ndihmë mjekësore shtetasi F. T. (Xh), 37 vjeç, banues në Berat, i plagosur me armë zjarri në rrethana ende të paqarta, në hyrje të qytetit.*
>
> *37-vjeçari ndodhet jashtë rrezikut për jetën.*
>
> *Menjëherë është ngritur grupi hetimor dhe, nën drejtimin e Prokurorisë, vijojnë intensivisht hetimet për zbardhjen e rrethanave dhe sigurimin e provave, me qëllim dokumentimin ligjor të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve", njofton policia.*

K.B/E.H/Shqiptarja.com

TAG: fabiel toska | Berat | plagosje me arme zjarri

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
8 Dhjetor, 11:46
Shpallja e pluralizmit në Shqipëri në 1990, kush e ka meritën e vërtetë?
Studentët | Sali Berisha | Të gjitha bashkë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Lajme të tjera

Pjesë e grupit që kishin planifikuar të eliminonin një person në Berat, 46-vjeçari ekstradohet nga Spanja
8 Dhjetor, 10:26

Aksident në aksin Mbreshtan–Pashalli, kamioncina del nga rruga dhe përfundon në përrua, plagosen 4 persona
1 Dhjetor, 21:16

Katër aksidente në pak orë, 2 të vdekur në Tiranë dhe Fier! 18-vjeçarja shpëton mrekullisht pasi u përplas nga autobusi
Sokol Dema
1 Dhjetor, 17:42

Aksident me vdekje në aksin Roskovec- Berat! Makina përplas qytetarin që lëvizte me biçikletë (EMRAT+VIDEO)
1 Dhjetor, 11:29

Berat/ Përkujtohet 81-vjetori i Çlirimit, ministri Ervin Demo: Lufta e dëshmorëve, sublime
29 Nëntor, 11:36

Berati feston 113 vjetorin e Pavarësisë, ndërohet me kurora lulesh Përmendorja! Kryebashkiaku Ceca: Një ditë e shenjtë që na rikthen tek rrënjët
28 Nëntor, 11:34

Dimal/ Lumi Osum 'fundos' tokat bujqësore e shkatërron prodhimtarinë, banorët: Nuk kemi ushqim për bagëtitë! Shteti të na ndihmojë
Mimoza Sinanaj
27 Nëntor, 18:09

Moti i keq/ Lumi Osum del nga shtrati në fshatin Veterrik të Beratit! Qindra ha tokë dhe sera nën ujë
27 Nëntor, 12:01

Travel and Tour World: Turistët ndërkombëtarë 'pushtojnë' qytetin historik të Beratit
26 Nëntor, 08:27

Dimal/ Prodhimet e serave shkuan në lumë, banorët: Miliona lekë humbje! Asnjë institucion nuk ka ardhur për vlerësimin e dëmeve
Mimoza Sinanaj
25 Nëntor, 16:51

Babai harton projektin, vajza inspektore e firmos! Si përfitoi 150 milionë lekë drejtuesi i FRPD nga fondet e AZHBR për bujqësinë
25 Nëntor, 13:45

40-vjeçari qëllohet me armë në Insitutit, shkon në spital i plagosur! Autori e zuri në pritë në rrugën e lagjes, shpallet në kërkim (EMRAT)
Sokol Dema
23 Nëntor, 23:29

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje